


SKENDER TEMALI

KENGE
CIGANE



VJERSHA DHE POEMA

891. 983-1

T. 46

S

SKËNDER TEMALI

KËNGË CIGANE

(Vjersha dhe poema)

14302
56288

BIBLIOTEKA E SHËTETIT
GJIRKASTER

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

POEMË E ELEKTRIFIKUAR

Mbrëmë e shkrova këtë këngë të thjeshtë për dritat,
në mesnatë kur flinin shokët
e unë bëja postën e kapanonit,
mbrëmë kur kufitë, gëzimin dhe «Lavdi PPSH»
i shkruam me llamba
që nga Vermosh i largët
e gjer në shtëpitë e Konispolit.

Dhe sikur me shërbim të mos isha mbrëmë, s'do më
zinte gjumi.

Poetëve s'u lejohet të mos marrin pjesë në varimin
e natës,

se poetët janë bij të dritës,

se poetët janë bij të shtërgatës,

se poetët s'i zë gjumi kur populli ka gëzim.

Marrin racionin e gëzimit dhe, si llambë, e vendosin
në këngë,

se dihet,

kur çdo gjë më popullin e ndan,
dhe «kënga është bombë e flamur»,
dhe vargu është më i rëndë.

Flenë shokët.

Çfarë them? Zgjuar janë që të gjithë
edhe pse akrepet e sahatit u puthën e ngadalë u
ndanë,
se dritat e fjetores projektojnë para syve të tyre
luftëtarë rilindas, komitë, partizanë.

2.

Gurgullon sonte drita si gëzimi nga gjoksi i
Shqipërisë,
gurgullon ajo si ndjenjat më të pastra,
gurgullon nga burimet e kristalta të partisë,
gurgullon e sjell melodi të reja, agime më të bardha,
gurgullon nga hutat e moçme, nga pena e Naimit,
gurgullon si kangjelet e bardha të De Radës,
gurgullon dhe sjell zërin e Migjenit: Pak dritë!
gurgullon nga Skroska, barrikadat e Tiranës,
gurgullon gëzimi i diellit nga shtëpia e partisë.

Ndanë këtij gurgullimi dikush hedh 28 mijë lukuqe
e na vijnë këto lule e na varen në çdo llambë,
e gëzimi ynë me dritë të kuqe mbushet
e vallet dredhim bukur, e zgjojmë mijëra këngë.

O ç'këngë optimiste që këndojmë, hej!
Ç'këngë të zjarrtë për partinë thurën rapsodët,
poetët,
sa jehona e tyre mbush gjithë krahrorët
dhe do jehojë kokëlart tej shekujve.

3.

Dje ne patëm qitje dhe dolëm shkëlqyeshëm,
dje objektivin quajtëm «armik» dhe «errësirë»,
ndaj e shpuam tej e tej me dy milion plumba
se dy milion shqiptarë kanë pushkë e shënojnë mirë.

4.

Nuk flenë sonte shokët. Si mund të flenë vallë?
Sa shtylla ngritën, sa poema të dritës shkruan,
sa herë në dritë kthyen lumenjtë, ujvaret,
sa herë hidhërimin e tyre në elektrone shndërruan!

Si mund të flenë sonte? Në shtëpitë malësore
(në kullat e zbardha, me diell) rendin elektronet,
duke mbartur mbi supe amanetin e të rënëve,
duke mbartur fjalën e zjarrtë të Enver Hoxhës.

Fluturojnë elektronet, këta zogj të bardhë të stinës
komuniste;
lokomotiva e kohës ndalon kudo, shtëpi më shtëpi,
dhe u thotë njerëzve që e përshëndesin nga shkallët,
dritaret:
Merreni këtë gëzim, është juaji, juaji, juaji.

Merreni këtë llambë e vareni në dhomë. Është juaja.
Merreni këtë llambë e vareni në gjoks
si dekoratë që fituat në luftën kundër errësisë,
merreni e vareni mbi gjumin e paqte të foshnjës që
sot lindi,
merreni këtë llambë e verbonju sytë gjithë armiqtëve.

Lëvizin në ekranin e kësaj dekorate luftëtarë,
gjëmon pushkë e tyre që nga Deçiçi gjer në
Mashkullorë,
se jetën pa dritë e liri s'e deshën kurrë shqipëtarët
se dhe në buzë të varrit pëshpëritën dritë, pakëz dritë.

Projektohen në këtë ekran drite: pleq që qëndruan
si lisa,
duke qarë me lot të pastër nga gëzimi,
Qemali, duke i rënë himnit të dritës me violinën
që mori mbrëmë në muze,

Ndrec Ndue Gjokët, duke ndarë nga një copë diell
me nga një kalem e fletore në çdo kullë të Mërditës,
fëmijë që bashkë me çantat kanë marrë nga një
llambë,
barinj që në stane varën llamba në kokën e lopëve
të bukura,
montatorë që montuan drita mbi oxhakët e Tecit,
vajza elektriciste, duke u endur si flutura.

Merreni këtë llambë. Edhe atë vetë e prodhuam
edhe dritat me gjak e djersë vetë i sollëm,
dhe këto shtylla tensioni të lartë mes fushash,
si fidane pranverore, vetë ne i mbollëm,

5.

Nuk flenë shokët sonte.
Në duar u ngjan se mbajnë prapë izolatorë,
nga uzina e telit sikur zgjatin fillin e dritës së bardhë,

s'kur zgjatin rrezet e diellit dhe i futin te çdo njeri,
sikur i lidhin me llambat që ngjajnë si dardhë e artë,
ndaj nuk flenë ushtarët.

Si të flenë vallë?

Llamba si diell i zjarhtë ndrit fjetores,
llamba që instaloi partia mbi të ardhmen tonë
që nga Konispoli i largët
gjer në lartësitë e Vermoshit.

ARKITEKTURË E PRANVERAVE TË ARDHME

Para portretit të shokut Enver

Piktori hodhi me drojtje firmën në portret.

Vallë çfarë la pa thënë?

Kishte shetitur piktori jug-veri,
kishte mbledhur qëndresën e maleve,
pjellorinë e fushave,
buzëqeshjet e pranverave,
gëzimet e hovet e kantiereve
dhe të gjitha i derdhi në portretin e tij.

Vallë çfarë la pa thënë?

Mori rrudhat e kohës e i vuri në ballin e tij,
nga sytë shtriu një arkitekturë të rrallë
të mendimeve të së nesërme,
arkitekturën e pranverave të ardhme,
arkitekturën e pranverës së përjetshme.

Kështu piktori i tha të gjitha.

INAUGURIM

Vëllimit tim

Një punëtor në shtypshkronjë do t'ju mveshë
kopertinat,
një tjetër do t'ju ngrëjë në spondet e maqinave;
do shpërndaheni ju vëllimet e mia
si pëllumba.

Do t'ju marrin në duar punëtorët që shumë desha,
vashat e urta,
sharrëxhinjtë, studentët, peshkatarët mbi lundra,
ushtarët do t'ju fusin në xhep me kujdes,
ashtu si në vezme vënë plumbat.

Ky është inaugurim,
ashtu si çdo inaugurim,
i zhurmshëm, gazmor,
me një bagazh të rëndë shqetësimi...

KËNGA JUAJ ËSHTË IMJA

Që fshati ka vetëm një poet, mua,
kjo nuk është fare e vërtetë;
ndonëse çdo kalli sa jetën e dua,
pa ju, bashkëfshatarë, kënga është pa jetë.

Kur gruri ngjan si det në këngët e mia
e kur aksionet ndritin si agime,
do t'thotë që kënga për grurin, aksionet
është këngë e tyre, që mba veç firmën time.

E kur në fushë mbledh kallingj e mendime
dhe i vendos në poemë si duajt,
s'kam si të them kjo është poema ime,
kur në çdo rrokje shkëlqen djersa juaj.

E kur në mbledhje ngrihi të vendosur,
kur shkarkoni me guxim paragjykimet,

e kur unë shkruaj ndaj nate për ju,
si mund të them: kjo është kënga ime?

Ndaj, që fshati ka vetëm një poet, mua,
kjo nuk është fare e vërtetë,
se ju, bashkëfshatarë, pleq e vërsnikë
jeni këngëtarë të jetës e jeni poetë.

SHOKU ENVER NË KËLMEND

Bien qindra çifteli, lahuta e lodra përnjëheri.
Gëzimi i malësorëve të alpeve fluturon si shpend.
Mes grykash të ashpra, kreshnike vjen Enveri,
kalon me diellin mbi supe udhëheqësi në Këlmend.

Si më i urti plak që kanë njohur këto shtigje,
flet Ai dhe në mbarë Këlmendin asgjë s'pipëtin;
nga fjala e tij si gjethet seç dridhen armiqtë,
fjala e tij si pranvera shpraz, mbi Këlmend,
lumturinë!

1 MAJ

Edhe mendimet për ty, një maj, të kuqe më
shpërthejnë,
kur përpara tribunës derdhet gëzimi popullor
kur marshoj krah për krah me uzinat, kooperativat
bujqësore.

tek mbaj Albanën, motrën time.
si një lirikë të këndshme në kraharor.

Dhe sheshet dashuria e klasës i mbush,
i mbush pranvera me ngjyra të ndezura
dhe mbi glob
zëri i fortë i pesë kontinenteve
godet në zemër të kapitalit si grusht.

Ndaj mendimet për ty, një maj, të kuqe më
shpërthejnë.

BERBERJA E PARË

Ti erdhe.

Sala, berberi plak, seç tha diçka shpejt për
emancipimin

dhe, nga hutimi,

për pak ja preu krejt

mustaqet

kryeagronomit të rrethit,

Selimit.

Ti qeshe lehtë.

Turp — mendoi xha Sala —

të qeshësh për mustaqet e Selimit.

Ti erdhe.

Dy vërsnikë të tu

lanë xhiron që bënëin shetitores

dhe zgjatën, si pata të egra,


qafat e tyre të holla,
të pjerrëta,
te xhami i rrojtores.

Zgjatën kokët dhe një plakë,
një grua,
djali i postierit...

Mirë se erdhe, moj shoqe!
Sekretari i organizatës bazë u ul në karrigën
tënde i pari.

Me gërshërët e tua
ti do presësh flokët e gjatë të paragjykimit.

Mirë se erdhe, moj shoqe!



SHQIPONJA E MALEVE

Kushtuar Tercze Gjinit

Nga nata dolën dhe me gjuhën e natës të folën...
Ti sisën nga goja e foshnjës hoqe,
që flinte dhe shihte kushedi se ç'ëndrra të bukura.

Bubullimat me grushte të fuqishme u binin
horizonteve,
me grushte ata zunë t'i binin derës së kasolles:
«Ha — pe!»

Vetëtimat gjarpërinj të zjarrtë lëshonin mbi malet
e thikta,
ata derën e kasolles qëllonin me shkelma e thika:
«Ha— pe!»

Ata hynë në dhomë.
Në skutën e dhomës së padukshme

fëmija jote, Tereze, kushedi se ç'ëndrra të bardha
shihte.

Të zunë për flokësh: «Ky fund për ty, Tereze, do
të vinte...
Dashuria për partinë thellë e më thellë në zemër
rrënjët e saja shtrinte.

Në dhomë mbet vetëm pisha me dritën e saj të
zbetë,
në dhomë një ninull e lënë përgjysmë,
ëndrrat e bardha të foshnjes, Terezë.

Kryqëzoheshin shtizat e rrufeve në logun e gjerë
të maleve,
kryqëzoheshin vështrimet dhe mendimet me të
armiqve.

Nën dritën e këtyre vetëtimave thikat në zemër
të hynë,
nën dritën e këtyre vetëtimave
kohërat të hodhën me grushte lavdinë!

PEISAZH LËVIZËS

Shokut tim, Llambros.

Në muzgun e Sarandës pashë portokajtë si fenerë
të vegjël,
ndjeva dashurinë e detit dhe refrenin e dallgëve,
fola me njerëz që u lulëzonte pranvera në sy,
me vajzat që mbanin në duart e regjura
portokalle.

Dridhej muzgu mbi supet e Sarandës...
Vajzat, me vreshtat mbi supe, nga kodrat zbrisnin,
Dhe sillnin aromën e tokës dhe këngën e Lejla
Malos

SHOTA

Ra një shkëmb nga malet
dhe në të gdhendëm trimërinë tënde:
me fytyrën e ëmbël dhe të ashpër si të Kosovës,
me duart mbi dhjetëshe si të Kosovës,
me urrejtjen dhe dashurinë si të Kosovës,
me kokën lart si të Kosovës,
Shote Galica!

ROZAF A

Pikon qumshti yt i bardhë nga gjitë e bardhë të
legjendave
dhe mbushen bedenet e kullat nga thirrjet e fëmijëve
kur ti ngjit kaq lart, Rozafë, dashurinë e nënave.

...Pikon qumështi yt i bardhë nga gjitë e bardhë të
legjendave...

FLETËRRUFE!

Më ngritën një fletërrufe në ndërgjegjen time,
në stendën ku vlon lufta e kritikës, e autokritikës,
se mua shpesh në zyrë m'u ngatruan këmbët
me të karrigës

sa s'dija të dalloja
cilat këmbë ishin të miat
dhe cilat të karrigës...

Vinin sharrëxhinjtë në zyrë (tek unë)
të qanin një hall, të bënin një ankesë.
Helbete, mendoja, një orë për mikrohalle të tilla
një sharrëxhi jashtë zyrës së drejtorit duhet të
presë...

Dëgjoja nga zyra sharrëxhinjtë që sharronin
trupat
dhe nuk më vajti mendja ndonjëherë,
porsi trupat dhe ndërgjegjen time,
vende-vende të kalbur, si trungun do ta sharronin.

LIRIKË E THJESHTË

Të bukura bëhen rrugët periferike të Tiranës në
vjeshtë,
kur ti kalon nëpër tunelin e artë të gjetheve të
pemëve,
nën dashuritë e zogjve, si një lirikë e thjeshtë,
duke mbartur në sytë e kthjellët tingujt e këngëve.

Kur gjethet bien e ar' i tyre ndrit vjershave të
poetëve,
me tingujt e ngrohtë ti më kujton, më thërret pa
pushim.
Ngrihet kënga jote mbi krahët e artë të laureshave,
dhe hyn në zemrën time të mbështjellë me gëzim.

Ti bjeri pianos, pianistja ime, bjeri ngrohtë, ëmbël
dhe thirrmë e kujtomë në mbrëmjen e fundit të
vjeshtës.

S'ka më të bukura se rrugët periferike të Tiranës
në pranverë.

Nën qiellin e kaltër çapi yt i shpejtë si ritëm troket,
ecën nën dashuritë e zogjve si një lirikë e thjeshtë,
o shoqja ime e mirë, e urta pianiste!

J E T Ë . . .

Sonte nëntë dasma pa gjumë lanë nëntë pallate,
sonde nëntë çifte fjetën të shkujdesur në nëntë
shtretër
dhe panë shumë ëndrra të bukura,
dhe panë shumë kaltërsi.
Mbi duart e tyre si pëllumba gugurisnin fëmijët.

Fëmijët e tyre të ardhshëm,
të bardhë si shkuma,
në jastëkun e virgjër mbështetën kokët e tyre të
bukura,
mes mamit dhe babit të ardhshëm fjetën si
pëllumba
e ëndrra panë me arinj, me lepuj e me flutura.

Kështu sonde në nëntë dasma lëndoi e këndoi
një gërnetë,
kështu sonde nëntë çifte fjetën nën dashuri e nën
hënë.

Fëmijët e tyre të ardhëshëm me të qarat,
lumturinë,
haretë,
me pagjumësinë e tyre të hareshme
kokën mbështetën në këtë këngë.

P U T H J E T

Redaktor,
në ke dashuruar ndonjëherë,
mos ma hiq këtë puthje nga vjersha,
se zemërohet pranvera e s'më sjell blerime
e ndofta më merr mëri edhe vjeshta.

Për atë puthje nuk prisha pesë palë këpucë;
me Anilën u putha ndaj muzgu, në vjeshtë,
kur pastruesit vjeshtën e mblidhnin në rrugë,
kur shove ti abazhurin e re për të fjetur.

Redaktor,
në ke dashuruar ndonjëherë,
mos ma hiq nga vjersha këtë puthje,
lëre lapsin, flake atë tej
dhe mos e kthe poetin në një lutje.

Mundet nga puthja të më lindë vajzë,
ty djalë
E ndofta, kur të rriten, do bëjnë dashuri,
po vallë do mundesh t'u redaktosh ti puthjet
me lapsin tënd të verdhë, të zi?!

Po ti kryq i bie puthjes sime në vjershë
e unë, i nevrikosur, iki nga redaksia,
vet' i dytë shetis parqeve të vjeshtës,
për inatin tënd me puthje më mbulon Anila.

Redaktor,
në ke dashuruar ndonjëherë,
mos ma hiq këtë puthje nga vjersha,
se zemërohet pranvera e s'më sjell blerime,
e ndofta më merr mëri edhe vjeshta...

DRURËT E DASHURISË

Lëkunden e lëkunden pa mbarim në peisazhet e
kujtesës sime,
herë krejt të gjelbër,
herë krejt të verdhë,
herë krejt të kuqe nëpër muzgje
dhe më kujtojnë gjethet e arta që më ranë mbi
lirika,
një vizion të largët,
një puthje. . .

Ju desha kaq shumë
E kaq pak vend ju lashë në këngë,
por në peisazhet ngjyrë gri të kujtesës sime
ju ngrihi e afrohi drejt meje,
Si shokë të singertë të dashurisë së parë.

KËSHTU NA SHKOFTË JETA!

Flautit të dimrit po i bie veriu,
qielli shkund lule bore mbi horizontin e këngëve
të mia,
mes kësaj dashurie të bardhë ne ecim të
shkujdesur,
si dy zogj të lumtur,
mes njerëzish,
mes rrugëve të zhurmshme me drita.

Kështu na shkoftë jeta, mes luleve, e dashur.
Le t'i bjerë flautit të dimrit veriu sa të dojë,
ne jemi bij të pranverës
dhe s'ka ç'na bën dimri i ashpër,
ne jemi bij të pranverës dhe mes gjelbërimit
rrojmë.

THONË SE TI ...

Thonë se ti je shumë e bukur, thonë,
se sytë e tu vajzë tjetër s'i ka në katund,
se kur pulit qepallat e bukura, thonë,
pranver' e dashurisë vetëm gëzim shkund.

Thonë se çupë e xha Hasanit, thonë,
na qenka dhe mjelsja më e mirë në fshat,
dhe shoferi i kooperativës, Gëzim e quajnë,
që i puthi sytë një natë, na paska goxha fat.

E çfarë s'thonë për ty, moj Hadije,
çfarë nuk thonë,
kur ti kalon fshatit pas lopëve me gjitë e
mbushur:
pleqtë, plakat dhe gratë, çupat dhe çunat
sikur kushedi ç'faj ke bërë që ke sy kaq të
bukur!

* * *

Gjithëmonë i kam dashur shoferët,
(shofer desha të bëhesha kur isha fëmi'),
të rendja e të rendja udhëve të Shqipërisë,
po ja, u rrita, brisk i rashë fytyrës
dhe, siç e shihni,
eca shtigjeve të poezisë.

E dija
se të bëhesh shofer
mjaftojnë ca muaj të marrësh patentën,
por nuk e dija se poet
mund të mos bëhesh dot
edhe gjithë jetën...

G R E T A

Dikush, mbi parmakun e hekurt të urës, kish
salduar një emër:

Greta,

kish salduar aty dashurinë dhe kujtimin e Gretës,
pagjumësinë dhe poezi të që shkroi dashuria
për vajzën që sipër gjive i tundeshin dy gërsheta.

Kalojnë njerëzit mbi urë me duart mbi parmakë
dhe ashtu, pa dashje, përkëdhelin emrin tënd,

Greta,

sikur përkëdhelin baluket e tua të arta,
sikur përkëdhelin që të gjithë dy gërsheta.

Greta! Tashti emrin tënd saldova në këtë vjershë,
mbi parmakun e kësaj këngë unë vura emrin tënd.

Saldatori diku ka ikur në një kantier, në një
vjeshtë,
dhe ja, kënga ime drejt saldatorit rend.

...Dikush mbi parmakun e hekurt të urës kish
salduar një emër: Greta,
kish salduar për vajzën sykaltër aty dashurinë;
kjo ngjau një ditë të bukur, një ditë në vjeshtë,
ndërsa kjo këngë u shkrua kur petalet mbi ty
bien e bien,
Greta!

VAJZAT TONA

Ti ke nxjerrë kokën e bukur nga dritarja e
maternitetit.

Mbi pishat e bulevardit zbret jehona.

Ti më gjegjesh fort nga kati i tretë:

«Më e bukur nga të gjitha çupat që lindën është...
jona!»

Unë buzëqesh e baballarët tanë më kujtohen këtë
çast,

që sa herë vendosën nënat tona të mira të ndanin,
sikur pas çupave mos të lindnim ne, djemtë,
se pushka jetime u varej në mur,
se trerët e shtëpive zinin e qanin.

...Të gjegjem. Ti me shenja ma bën: s'dëgjoj,
veç kupton se gëzimi i babait rrjedh e nuk ndalet,
se vajzat linden n'transhe t'revolucionit
të shëndetshme dhe të bukura
si këngët dhe ujvaret.

DASMË NË STAN

U ul baca këmbëkryq në vatër,
pak duhan hodh mbi çibuk të gjatë;
në ç'stan të bënë nuse sonte, motër?
Këng' e dasmorëve ku jehon këtë natë?

Por nuk fliste baca asnjë fjalë,
veçse thithte llullën gjer në fund;
hëna po bariste përmbi stane,
kope yjesh bridhnin mbi katund.

E ndër brigje, tej, atje në stane,
këngë e valle u përziën bashkë,
maleve rendin ca këngë çobane,
vallet hidheshin hopla përmbi flakë.

Heu, martohet Dila me çobanin,
një kupë qumësht ngrenë barinjte me fund;
blegërinin delet kaq ëmbël,
kope yjesh bridhnin mbi katund.

KUR PUNOJMË NË TURN TË TRETË

Vërtet u lodhëm mbrëmë,
të lodh ky turn' i tretë;
ju, njerëz, duke fjetur ju lamë
dhe ju gjetëm po fjetë.

Dielli na lind mbi supe gjithnjë.
E mbartim, e sjellim tek ju,
e varim mbi vogëlushen që fle,
si lavjers' të kuq qiejve tan'blu.

Pastaj ju e ruani e ne flemë;
gjumë të ëmbël bëjmë në shtëpi,
të sigurt se nesër më të zjarrtë
diellin ne do sjellim përsëri.

SHTIU DIKUSH ME PUSHKË KUNDËR KËNGËS SATE

*Poeti palestinez Abu Mu-
rin u afrua te një shkrep dhe
dëgjoi nga larg zëra të mby-
tura të rojeve izraelite...*

(Nga shtypi)

Shtiu dikush me pushkë kundër frymëzimit tënd,
poet,
t'i gjakosi rimat e ngrohta, këngët e pakënduara,
andaj rroke pushkën...
Përballë teje izraelitë me maqina të blinduara.
Natë. Vendos ndanë udhe një minë. Pret.

Ti pret. Pres dhe unë bri radios,
Si eksploziv shpërthejnë fjalët e spikerit:
«U vendos një minë, dhjetë izraelitë u vranë...»
Ndaj, kur të kujtoj ty, Abu Murim,

që ndjell rezistencën me këngë e mina,
një zjarr të ri ndez në shpirtin tim.

Ecën tok me shokët. Mbi supe mban një partizan.
Gjaku i tij mbi këngët e tua bie i ngrohtë, me
rrëmbim,
mbi shpatulla diellin me trëndafila drite mban
mes rreshtash luftëtare,
poeti partizan Abu Murim.

SHAMIA E NËNËS

Kur mora rrogën e parë nënës i bleva një shami,
një shami, ku vajzat e kombinatit kishin hedhur
lulet e pranverave,
ku kishin qëndisur ëndrrat e tyre në trajtën e luleve,
me një harmoni të çuditshme,
me diell.

Vrapova me të në duar drejt dashurisë së saj.
Erërat ma morën shaminë dhe e ngritën në horizont,
ma morën nga duart dhe e hodhën mbi gjithë kokët
e zbardhura të nënave shqiptare,
mbi dashuritë e tyre hodhën lulet e fushave,
rudinave
e maleve.

Kur mora rrogën e parë nënës i bleva një shami. . .

AGRONOMI

«Mirë mëngjezi, agronom» — të pëshpërisin fushat,
«Mirë mëngjezi» — të thotë dhe balta përmbi gju,
në sfondin e mëngjezit — mjelësja e dalluar e lopëve,
sytë e saj të ëmbël si copëra qielli blu.

Kur mbrëmja ra, ti prapë fushash kalove,
mes grunjërash me mjelësen, Manushaqen.
Grunjërat, si çupa të turpshme, kishin varur kokët
dhe pëshpërisnin: në fshat së shpejti kemi dasmë!

DRUG PALLAÇJËJ¹⁾

Jevtushenkos

Dhe gjethet e pemëve në vjeshtë të bukura janë,
por bien nga flladi më i lehtë,
bin e kalimtarët i shkelin me këmbë...

Bien.

Dridhen tek bien

trotuareve të kohërave një nga një.

Si këngët e tij bien këto gjethë që varen në pemën
revizioniste,

që dridhen,

që bien gjer larg në Spanjë,

mbi gjunjët e Frankos,

si kartvizita të verdha, të verdha të stinës

revizioniste.

Gju më gju me Frankon, poeti i kabareve,

që ja morën mendtë serenatat e muzgjet e bruzda,

që neveri i sillnin të varfërit me duart e shtrira

porteve,

rebelët me kërkesat,
grevat si dallgë shumballëshe të detrave,
zemërimi i poetëve.

Zemërimi i Spanjës — më i madh se zemërimi i
poetëve.

Po largohet nga Spanja.
Frankoja tund dorën e përgjakur,
që bie si hanxhar mbi kokën e lirisë.
Pas prangave të burgut Spanja bluan urrejtjen,
prangat vringëllinë...

Kontinentet me durt e shtrënguara të proletarëve
rrahin tamburet
dhe nga gjëmimet këngët e Jevtushenkos si
gjethe bien,
dridhen tek bien,
u shurdhohen timpanët.
Globi i shkel pa mëshirë me këmbë.

Kështu bien e shkelen me këmbë dhe tiranët,
o drug pallaçej!

1) Drug pallaçej (rusisht) — mik i xhelatëve.

NË OKB

Këtu shtetet ulen në karriga të lustruara
dhe me fjalë, debate,
zihen shtetet për jake,
për gjoksi,
për krevate. . .

Diku, në një vend, ka qëndruar përfaqësuesi
shqiptar
me grushte të shtrënguara përmbi tavolinë.
Ai dëgjon.
Dëgjon Shqipëria për kushedi të satën herë
tek bisedojnë imperialistët për «paqen»,
dhe,
në vegim të fjalëve bajate
ndjen si mprehin shpatën
ndaj shtrëngon fort nga urrejtja grushtet proletare.
Shtërngojnë grushtet uzinat,
fushat
e malet shqiptare.

MIKU I DIELLIT

Unë diellin gjithë jetën e kam dashur
aqë shumë sa gjithnjë e futa në këngë,
sikundër futa së toku gjithnjë
të sotmen, të nesërmen të rënët.

Babai im diellin e fitoi me djersë,
babai im na e solli në shtëpi,
bashkë me shokët një ditë e ngriti
në qiellin e mehallës, mbi çati.

Dhe unë u ngjita një ditë mbi çati,
U ngjita dhe kokën tek ai mbështeta
Dhe ndjeva të më vërshonte nëpër gjithë
trupin
dhe nëpër gjithë këngët ngrohtësia e tij.

Një ditë dielli më mori për dore
më çoi galerive, në shkolla, lart në qiell,
më çoi në trase, ku vajzat aksioniste
e morën ngrykë babaxhanin diell.

Kështu, unë dhe dielli u bëmë miq,
aq miq sa gjithnjë e futa në këngë,
sikundër futa së toku gjithnjë
të sotmen, të nesërmen, të rënët.

FUND VERE NË PLAZH

Nesër do të lëmë dhe ty,
plazh.

Do të vijë vjeshta
duke shtyrë mbi det tufat e reve
dhe do mardhësh ti nën stuhi,
i vetëm
nën kryqëzimet e ashpra të rrufeve.

Në kantieret veriore, ku bora zë thinjë,
do na shfaqesh i zhurmshëm ti
që pret në breg i vetëm
si një mimozë e lumtur
të vijë pranvera përsëri.

Nesër do të lëmë dhe ty.

Do ikim. Të mbështjellë me reflekset e detit.
Në biseda do t'ju përmendim si shokë të
ngushtë

detin e gjerë
dhe ty.

TUNGJATJETA VJESHTË!

Vjeshtë tungjatjeta,
vjeshtë moj bjondinë,
ç'i përzure zogjtë,
morën arratinë.

Vjeshtë, vijnë retë,
mbi supe të rrinë,
tok arat dhe vreshtat
në pazar po vijnë.

Sot dhe picirukët
Ja, po shkojn' në shkollë,
ti u fal një dardhë,
një kumbull, një mollë.

Nisen montatorët
në tjetër fole,

këtu shih, e lanë
një fabrikë të re.

Vjeshtë tungjatëjeta,
vjeshtë moj bjondinë,
horizontesh larg
ti më tund shaminë.

DEA E BUTRINTIT

Mes gëzimit të arkeologëve — Dea e Butrintit,
Dea e bukur, e dashuruar,
si një nimfë e ndrojtur, e sinqertë,
me bukurinë e saj të pafajshme.

Flenë arkeologët. Gjumi i tyre s'është si i gjithë
njerëzve,
është tjetër gjumë.
Në gjumë ata hapin dyert e shekujve,
hyjnë në dhoma mbretërore e pushtojnë kohërat
pa britma, pa bujë.

Dea mes tyre.
Prapë ka frikë mos vijnë ata, që çmendeshin pas
saj, ta grabisin;
Dea pret t'i vijë i dashuri ta marrë në kalë, si i
kishte thënë,

ka frikë mos ja vrasin a në vise të tjera ja çojnë.
Por hesht qyteza arkeologe. Vetëm yjet për të diç
pëshpërisin.

Diç pëshpërisin dhe arkeologët.

E dashurojnë që të gjithë këta njerëz të thjeshtë,
hijerëndë.

Mes tyre ajo ka hyrë si mes këngëve të poetëve,
që çmendeshin pas saj dhe e futnin në këngë
dhe ajo është e tyre, ashtu si dhe dielli është i të
gjithëve.

Mes gëzimit të arkeologëve — Dea e Butrintit,
Dea e bukur, e dashuruar,
me dliresinë e bukurinë e saj të rrallë,
të parestauruar.

MIRËMËNGJEZI, LENË!

*Lena Gjokës, kryetare e kooperative
bujqësore të Gruemirës,
Shkodër.*

Ecën mes ëndrrave e djersës sonë përditë për
rendimentin e të lashtat
me çizmet tërë baltë, me flokët të lidhur me shamitë
e ylbereve,
përkëdhel tufat e deleve si fëmijët me pëllëmbët e
ashpra
e tufat të mbulojnë me blegërima si me mijëra
buzëqeshje:

pa ja hypën dhe kalit e shkon fushave, sektorëve,
ku shtretërit e nxehtë qajnë në xhame,
ku verojnë bagëtitë,

ku stanet rëndojnë nga dëbora, ku projektohen
shtallat,
në vatër të kulturës, në valle me të rinjtë.

«Fushave ngele, o bijë, dhe e staneve mbete»,
të duket se të flet Gruemira me zërin e nënës.
Pa çlodhu njëherë në zyrë, pa mendo për vete,
ti që del fushave e kthehe veç nën dritë të hënës.

Buzëqesh. Mbulon peisazhet rrotull buzëqeshja jote,
nën buzëqeshje gruri rritet, me qumësht mbushen
bidonat,
makinat grijnë silazh, kurriz peshku kthehet toka
dhe pluhur lënë, duke rendur drejt depove të shtetit,
kamionat.

Mbrëmë, kur nga fushat ktheve e lodhur në shtëpi,
të zuri gjumi i ëmbël mbi plenumin e nëntë;
po ç'ëndërr të bukur pe mbi broshurën e kuqe,
gjersa çanga jehoi?

Luginave si lule të bardha u shpërndanë dhentë.

ELEGJI E MONTATORIT

Gëzimet u çmontuan,
u thërmuan dhe ranë mbi pëllëmbët tona si qelq.
Shokun e brigadës mbartnim në krahë,
shokun do varrosnim mbi kodër, te një shteg,

që ta shikonim sa herë mbi shtylla të ngjiteshim,
që ta shikonim sa herë mbi to fitore të montonim,
sa herë që të dashurat diku mbi kodër të takonim.

Saldatorët qenë ngjitur mbi kantier dhe saldonin,
saldonin,
Harqet e shkëndijave si yje pikonin nga qielli ynë i
dashurisë
dhe montatorin tonë e mbulonin,
e mbulonin,
e mbulonin.

Lamtumirë, shok!

Jo me copëzat e dheut
po me gjëmimet e kantierit po të mbulonim.

Lamtumirë, o montator i mirë!

NDANË SENËS, MBI SHARKI...

Unë jam miku më i ngushtë i shtegtimit të reve,
jam bir i kësaj toke, që quhet Kosovë,
unë jam këngëtari më i rrallë i mallit të
mërgimtarëve
që, tok me këngët, kam futur shtëpitë,
të dashurit,
të vrrarët,
në një torbë.

Ndanë Senës, mbi sharki, nga dhimbja bulojnë
këto këngë,
nën minaretë e Stambollit diç thonë gishtërinjtë e mi.
Rendin retë e zeza në horizontet e mbyllura të
këngëve
dhe dhimbja rend mbi pesë tela, rend dhimbja
mbi sharki.

Vë kokën mbi sharki, si mbi një trung të stërllashtë,
(sharkinë e pata bërë nga një trung atje, larg, në
Kosovë).

Më rrahin brinjët valët e Senës, erërat e forta të
kurbetit.

Mbeta pa atdhe,

pa grua,

pa vatër,

pa të dashur,

si një plep i vetëm që e fshikullojnë mallëkimet e
anëdetit.

Dhe në bel të plepit lëkundet e lëkundet një torbë,
një torbë,
një torbë...

KËNGË CIGANE

E ç'mund të isha unë pa partinë?!..

Një cigan i mjerë me dy dajre në shpinë,
Një lypës derë më derë me mijëra halle në shpinë,
një njeri pa adresë,
pa plang,
pa shtëpi.

Bam-bam, bam-bam!
Rreh mbi kudhrën e hidrocentraleve çekani im
dhe fluturojnë shkëndijat rreth e qark.
Do të isha i përbuzur nga të gjithë,
Me dorën e shtrirë,
pa bukë në bark.

Ku linda askush nuk e di.
Ishim pa «vendlindje» ne, ciganët,
brez pas brezi,
përherë,
endeshim si fantazma ne, ciganët.

Çadrat tona mbinë gjithkund, si kërpudha të
bardha.

Po askund etërit nuk e gjetën lumturinë,
e prapë nuset e reja me gërsheta të gjata
mbi kokët e bukura të rrethuara me shamitë me
ojma

mbanin të heshtura
kasollet.

Lëkundeshin kasollet tona mbi kokët e nuseve
me gërsheta,
ecnin kasollet tona mes mjerimit, si të dehura,
lëkundeshin si të shkreta,
pa dritë,
pa diell,
të zeza mbi kokët e nuseve fatzeza.

Lëkundeshin bashkë me shtëpitë dy dajre,
dajre të bukura për ahengxhitë mejhaneve,
dajre për të rrahur me shuplaka mbi to hidhërimet
e jetës,
dajre,
dajre mbi kokët e nuseve me gërsheta.

Dhe ishin baballarët e mi mjeshtrit më të rrallë
të dajreve,

dhe ishin baballarët e mi mjeshtrit më të rrallë
të farkës,
po kurrë nuk u buzëqeshi zemra një herë,
kurrë në xhepe s'u mbeti një kacidhe qyqarëve.

Shpesh vinin mbrëmjeve tapë, të pirë,
shpesh puthnin nënat tona, gratë e tyre, në sytë
tanë,
shpesh shpirtin e tyre e pamë sa i bardhë ishte,
i mbushur me shkulma gëzimi.
i kthjellët,
si deti i gjerë.

I provuan të gjitha zanatet baballarët tanë,
që nga dajretë, farka e gjer te shitja e gomarëve,
po xhepet e tyre qenkeshin shumë të gjera,
sa deti të gjera,
ndaj humbiste si peshku në to grushti i parave.

Nënat tona të mira për çdo vit përballonin lindje.
Lindëm ne në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Sauk. . .

dhe çdo njeri kish një gojë për të ngrënë,
dy duar për tu kapur leckat baballarëve:
duam bukë, bukë!

Dhe zumë të këndonim mejhaneve për zotërinjtë,
vajzat më të bukura zgjodhëm dhe në valle i
futëm,
që të kënaqeshin zotërinjtë, «baballarët e kombit»,
që shpesh në sytë tanë vajzat na i puthën.

Ne ndërpreme këngën,
të nevrikosur rrugëve ikëm.
Në faqe të vajzës kish mbetur e puthura
dhe mbi të napoloni që zotërinjtë i ngjitën.

Por prapë të nesërmen vajtëm në mejhane,
prapë këngët popullore përcollëm me qemane,
prapë vajzat më të bukura i hodhëm ne në valle
«bravo — çirreshin — bravo, mbretëreshë cigane!»

As vetë s'e kuptoj si këndonim atëhere, s'e kuptoj,
kur s'na jepnin bukë djersa, dajretë, gomarët e
farka.

Pas këngëve të mejhaneve na prisnin gratë e
trishtuara,
fëmijët tanë të shumtë me të qara.

Po dhe fëmijët tanë i mësuam të këndonin,
të hidhnin valle, mbi violinë të dridhnin harçua,
që, të paktën, të paktën një herë në javë
dasmave të botës me bukë tambushnim barkun.

Dhe erdhi lufta...

Prapë dasmave, mejhaneve vajtëm,
ku venin zotërinjtë me damat e tyre ezmere
dhe, duke kënduar tavolinë më tavolinë,
njëri nga ne i vodhi italianit revolverë.

Partia e Nëndorit mbi botën tonë u var si diell,
diell mbi botën tonë të zezë,
mbi këngët tona diell.
Ndonëse shumë atëhere këtë diell s'e njihnim,
ne e quajtëm: Dielli i mirë.

Notonin re të zeza horizonteve të mbarsura me
elektricitet,
këngët tona ngriheshin mes krismave të naganteve,

gjersa një natë,
pasi këceu valle me shami të kuqe,
me bohçe të kuqe,
me buzëqeshje të kuqe,
valltaren, bijën tonë, na e vranë gjermanët.

Bijtë që përcollën nënat cigane, s'u kthyen të
gjithë nga malet,
mbetën disa gërxheve përjetësisht,
mbeti ai që desh aqë shumë valltaren cigane,
që unazën e saj të tunxhtë e mbante në gisht.

Në sheshet e lirisë tundëm fort dajretë,
i shpërndamë qytet më qytet,
shumicën pa para,
me shokët partizanë hymë «hopla» në vallet,
të qeshur, siç hynte, dikur, valltarja që na vranë.

Dhe nisëm të endeshim prapë, si dikur, Shqipërisë.
Udhëve natyrisht na lindën fëmijë të tjerë,
veç, kur shkuam në gjendjen civile për regjistrim,
pyetjes së nëpunësit iu përgjigjëm: lindi në
kantier!

U bëmë bij, baballarë të kantiereve;
Dalgadalë çadrat zumë t'i harronim,
këngët e farkës, që mbinin mes agimeve,
mbi shkëndijat e arta zumë t'i këndonim.

O ç'këngë e madhe kjo këngë e jetës!
Mes hoveve të saj ishim dhe ne, ciganët,
që për ditën e nesërme s'na zinte më frika.
Jeta para nesh kish çelur gjithë portat:
Mësuam shkrim e këndim,
hipëm skelave, hymë në shkolla
dhe s'fjetëm kur kantiereve u shfaq opera e parë,
«Mrika».

S'kishim si të flinim ne, muzikantët,
ne që linim nam në të gjitha festivalet,
se kënga jonë dilte thellë nga zemra
dhe vajzat tona të bukura që këndonin,
që hidhnin valle,
askush më s'i puthi në sytë tanë,
askush s'u vinte, mbi puthje, para.

Kazmat hodhëm kudo kantiereve,
gjer në brez në ujë dhe ne kënetave,
luftuam armikun e klasës si luftuam mishkonjat

dhe poligoneve të para,
pas qitjeve me pushkë,
mbilidhnim gëzimet si gëzhonjat.

Tokë s'patëm kurrë. Reforma na tha merreni
e mbilleni e korreni mirë për inat të kulakëve,
sa dhe bujqit e vërtetë të thonë:
U lumtë ciganëve.

Ca hidrocentraleve iu ngjitën. Duhej drita.
Fabrikat e para donin korrent.
Ndaj lamë dajretë, matrapazllëqet e gomarëve
që shtat hidrocentralet të hidhnin lumenjve sa më
shpejt.

Dritë! Për të verbuar të shkuarën e zezë!
Dritë! Për të kënduar gazetën dhe natën.
Dritë! Për uzinat e para e rrugët e reja,
për të dëgjuar në konak të tij malësori radion.

...Dhe prapë endemi poshtë e përpjetë Shqipërisë,
po çadrat nuk zbardhën më si në fusha luledet,
dhe jemi kudo ku na kërkojnë alarmet,
adresat tona tashti janë-kantieret.

Lindim prapë fëmijë. Emra të rinj u ngjisim
si Drita, Montator apo Centrale,
të shëndetshëm për beteja të reja i rritim
ne, që s'bredhim si dikur mejhaneve.

Ne partia na hapi të gjitha portat,
ua hoqi nuseve mbi kokë kasollet,
dajretë
dhe shportat.

nënave ua thau faqeve përgjithmonë lotët,
na mësoi të veshim në këmbët e zbathura
sandalet e thjeshta të NISH Gomës.

Ç'do të ishim ne pa partinë?..

PASQYRA E LËNDËS

faqe

Poemë e elektrifikuar (poemë)	3
Arkitekturë e pranverave të ardhme	9
Inaugurim.	11
Kënga juaj është imja	12
Shoku Enver në Kelmend	14
1 Maj.	15
Berberja e parë	16
Shqiponja e maleve	18
Peisazh lëvizës.	20
Shota.	21
Rozafa.	22
Fletërrufe.	23
Lirikë e thjeshtë	24
Jetë.	26
Puthjet.	28
Drurët e dashurisë	30
Kështu na shkoftë jeta!	31
Thonë se ti... ..	32
Greta.	34

Vajzat tona.	36
Dasmë në stan	37
Kur punojmë në turn të tretë	38
Shtiu dikush me pushkë kundër këngës sate	39
Shamia e nënës	41
Agronomi.	42
Drug pallaçej.	43
Në OKB.	45
Miku i diellit	46
Fund vere në plazh	48
Tungjatjeta vjeshtë!.	50
Dea e Butrintit	52
Mirëmëngjezi, Lenë!	54
Elegji e montatorit	56
Ndanë Senës, mbi sharki	58
Këngë cigane (poemë)	60

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stazh: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1971